

---

---

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “ Ritello Albania ” SH.P.K**

Ne Tiranë, sot me date 06.05.2023 , ne të nënshkruarit më poshtë:

- **Z.Stiljano Merkohitoj**, atësia Hyrjet dhe amësia Valentina , i datëlindjes 27 Prill 1992 , lindur në Vlore , shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga “ Muhamet Maze ”, Nd. 26, H.1, Orikuim ,Dukat Fshat 9426 Vlore, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 037657627 dhe numër personal J20427056L,

Ne baze e per zbatim te ligjit nr 9901 date 14.04.2008”Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “i ndryshuar dhe legjislacionit te Republikes se Shqiperise ne pergjithesi, vendosem si vijon:

**Kreu I**

**Emertimi, Selia,objekti,afati i shoqerise**

**Neni 1**

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga akti i themelimit,statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

**Neni 2**

Shoqeria do te emertohet ” **Ritello Albania**”sh.p.k.

**Neni 3**

Selia Qendore e Shoqërisë është në adresen: Tirane , Rruga Sokrat Miho , Pallati Livadhet Yzberisht ,njesia nr 21 nr pasurie 218/51-N21 zona kadastrale 3866.

Shoqëria mund te hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera,brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra ne vende të ndryshme, pervec selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

**Neni 4**

Objekti i shoqërisë do të konsistoje ne :

Import-Export si dhe Tregetim shitje me shumice dhe me pakice te pajisjeve elektroshtepiake dhe pajisjeve elektronike .

Shoqeria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji I zbatueshem ne Republikën e Shqiperise.

**Neni 5**

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te pacaktuar kohe

**Kreu II**

**Kapitali , ortaku , veprimtaria .**

**Neni 6**



## Kapitali

6.1.Kapitali themeltar I shoqerise eshte **100.000 leke(njeqindmije leke )** qe perben **1 kuote , sipas pjesemarrjes se themeluesve ne kapitalin e shoqerise ne perputhje me kontributet si me poshte:**

- **Z.Stiljano Merkohitoj** , atësia Shefqet dhe amësia Latife, , i datëlindjes 27 Prill 1992 , lindur në Vlore , shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga “ Muhamet Maze ”, Nd. 26, H.1, Orikum ,Dukat Fshat 9426 Vlore, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 037657627 dhe numër personal J20427056L., zoteron **1 kuote** me pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerise **prej 100%**(njeqind perqind).

6.2.Kuotat jane të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe Statut. Kuotat e kapitalit shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

6.3.Ortaku mban pergjegjesi te kufizuar ne marredheniet juridike –civile me te tretet,pergjegjesi qe kufizohet deri ne vleren e pashlyer te kontributit te nenshkruar prej tij.

### Neni 7

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

### Neni 8

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale dhe perfaqesi Brenda dhe jashte vendit ,konform ligjit shqiptar.

## Kreu III

### Organet e shoqerise .

### Neni 9

9.1.Shoqeria eshte e organizuar ne organet e saj drejtuese te cilat jane:

1-Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

2-Administratori

9.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht, në perputhje me ligjin dhe me Statutin vendime te cilat janë të detyrueshme per të gjithë ortakët perfshirë ata që mungojnë.

9.3.Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, jane si me poshte:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave

- 
- financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### **Neni 10**

**10.1.**Organi vendimarrës I shoqërisë „Asambleja e Ortakeve emeron me shumice të thjeshte nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqërisë.

**10.2.**Afati I emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripërteritje.Emerimi I administratorit prodhon efekte vetem pas Regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**10.3.**Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në cdo kohë, me vendim te marre me shumice te thjeshte nga Asambleja.

**10.4. Administrator I shoqërisë emerohet - Z.Stiljano Merkohitoj**, atësia Hyrjet dhe amësia Valentina , i datëlindjes 27 Prill 1992 , lindur në Vlore , shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga “ Muhamet Maze ”, Nd. 26, H.1, Oriku ,Dukat Fshat 9426 Vlore, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 037657627 dhe numër personal J20427056L,madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar .

Emerohet per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje.Administratori mund te shkarkohet me shumice te thjeshte nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

#### **Kreu IV**

#### **Likujdimi , riorganizimi , baza ligjore .**

#### **Neni 11**

##### **Prishja dhe Likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.;
- c)ne rast se objekti behet I parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqërisë apo per shkaqe qe bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregatre
- d)ne rastet e pavlefshmerise se themelimit
- e)ne raste te tjera te parashikuara ne ligj
- f)per cdo shkak tjeter te vendosur nga Asambleja e Ortakeve

#### **Neni 12**



---

---

### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

12.1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, I ndyshuar.

### **Neni 13**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji lex specialis në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 14**

#### **Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Për zgjidhjen e mosmarreveshjeve që kanë të bëjnë me interpretimin e këtij akti themelimi apo ato që mund të lindin midis ortakëve apo ortakëve dhe të tretëve, kompetente për këto do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtte ligjore.

Akti I themelimit pasi u lexua dhe u kuptua nga palet nënshkruhet prej tyre me vullnet të lire, të plote e të pavesuar.

### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**

**Z. Stiljano Merkohitoj**

STILJANO MERKOHITOJ

